

NJOFTIM
Nr. 748, datë 20.2.2023

PËR SHPALLJEN E 1 (NJË) VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT JURIST, ME AFAT 10 MUAJ, NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin e Specialistit Jurist, me afat 10 muaj, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- Të zotërojnë diplomë Master shkencor në Drejtësi;
- Të kenë eksperiencë pune, jo më pak se 1 vit;
- Të kenë njohuri të mira kompjuterike në përdorimin e paketës *Microsoft Office*;
- Njohuria e gjuhës angleze përbën vlerë të shtuar.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;
- Ndaj tyre të mos jetë nisur procedim penal, të mos jenë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;
- Ndaj tyre të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- Kandidatët duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidatët e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (originale ose të noterizuara);
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 6 mars 2023, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.